



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.03/25

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës I.C-S, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga B.A, avokat nga Peja, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 20.02.2025, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga B.A, avokat nga Peja, ndaj gjyqtarës I.C-S, **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 22.01.2025, B.A, avokat nga Peja, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarës I.C-S, me arsyetimin se e njëjta ka shkelur nenin 5 par.2, pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, thekson se e njëjta në seancën e datës 30.12.2024 ka paragjykuar rastin ku në aktvendimin e marrë në shqyrtim gjyqësor, në faqen e dytë të procesverbalit citon “mungesa e të pandehurës A.R, padyshim është një marrëveshje me mbrojtësin e saj, me qëllim të prolongimit të procedurës andaj gjykatës për të njëjtën do të lëshoj urdhërarrest”, sipas parashtruesit të ankesës gjyqtarja ka paragjykuar rastin duke vepruar në paragjykime se i njëjti me të pandehurën kanë bërë marrëveshje që të mos paraqiten në seancën e datës 30.12.2024. Tutje ka theksuar se këtë veprim e ka përsëritur edhe në vendimin e datës 09.01.2025, ku në faqen e dytë të këtij procesverbali citon “ku pa dyshim mungesa e të pandehurës është marrëveshje paraprake me mbrojtësin e saj me qëllim të shmangies së shqiptimit të dënimit mbrojtësit të saj dhe lëshimi i urdhërarrestit”, e sipas parashtruesit të ankesës gjyqtarja kryen detyra zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjykime dhe jo në bazë të fakteve dhe provave. Parashtruesi tutje ka deklaruar se në vazhdimësi është prolonguar rasti duke mos caktuar seancën e shqyrtimit fillestar edhe pse aktakuza është ngritur me datë 28.04.2023, ndërsa shqyrtimi fillestar është caktuar me datë 31.10.2023 me çka gjykata shqyrtimin fillestar e ka caktuar në kundërshtim me nenin 236, par.4 të Kodit të Procedurës Penale, ku në rastin konkret gjyqtarja në fjalë ka caktuar shqyrtimin fillestar pasi kanë kaluar më shumë se 180 ditë. Thekson se gjyqtarja nuk e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor brenda afateve ligjore siç e parasheh neni 249 par.2 të KPPRK-së, pasi që konfirmimi i aktakuzës është bërë me datën 22.01.2024, pasi që kundërshtimi i provave dhe aktakuzës është me datën 11.01.2024 dhe shqyrtimi gjyqësor është caktuar me datën 12.07.2024. Përfundimisht thekson se

veprimet e gjyqtarës në fjalë janë veprime që e prolongojnë procedurën që janë ndesh me nenin 5 par.2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në vazhdimësi ka bërë shkelje duke kryer punën në mënyrë joprofesionale dhe jo etikë në kundërshtim me Kodin e Etikës për Gjyqtarë. Referuar të sipër cekurave ka kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore dhe të shqiptohet ndonjëra nga masat disiplinore.

Me datë 22.01.2025, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga B.A, avokat nga Peja, ndaj gjyqtarës I.C-S.

Gjyqtarja I.C-S, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se që nga fillimi i procedurës penale ndaj të pandehurave A.P, A.R dhe R.K, lëndën janë duke e përcjellë obstrukcionet e mbrojtësve, e të gjitha me qëllim të prolongimit të procedurës, gjë që po e dëmton punën e gjykatës, integritetin e procedurës penale e po ashtu edhe interesat e palëve në këtë procedurë. Lidhur me pretendimin e mbrojtësit, se gjykata të njëjtit ia kishte shqiptuar dënimin me gjobë, duke e paragjykuar çështjen, deklaroi se Aktvendimin për shqiptimin e dënimit me gjobë gjykata e ka marr duke u bazuar në provat të cilat i ka vlerësuar, pasi që gjykata i vlerëson provat e në lidhshmëri me njëra tjetrën merr një vendim dhe duke u bazuar në provat dhe faktet, vendimi i marr në procesverbalin e datën 30.12.2024, është i drejtë, pa asnjë paragjykim. Ka theksuar se në këtë rast mbrojtësi, ka qenë i udhëzuar se mund të ushtrojë ankesë brenda afatit të caktuar, ashtu që në atë mënyrë i njëjti ka mundësi t'i shpreh pakënaqësitë e tij lidhur me vendimin në fjalë. Lidhur me pretendimin e mbrojtësit për afatet e caktimit të seancave gjyqësore, ka theksuar se janë çështje procedurale, e të cilat i njëjti ka mundësi t'i atakoj përmes ankesës mbi vendimin meritor të gjykatës, e jo të thirrë në çështje procedurale pa dashur të hyj në arsyetimin mbi ngarkesën dhe vëllimin e punëve të gjyqtarëve. Ka theksuar se mbrojtësi ka qenë i angazhuar që nga fillimi i procedurës dhe po të kishte pasur një ankesë të tillë, ka pasur mundësi që të parashtronte gjer më tani, gjë që vërteton se kjo tani është vetëm një arsye që të plotësohet kërkesa e tij, dhe të duket më serioze. Sjellja e mbrojtësit është jo profesionale, pandërgjegjshme dhe jo etike, është ai i cili po e keqpërdor rolin dhe të drejtat të cilat ia garanton legjislacioni në fuqi, pasi i njëjti si një profesionist i cili po ashtu i nënshtrohet respektimit të Kodit Të Etikës të përcaktuar nga OAK, dhe si i tillë në këtë situatë konkrete është dashur që të konsultoj dhe këshillojë palën e vet për të kuptuar pasojat eventuale të mos respektimit të vendimeve të Gjykatës të respektojë gjykatën dhe të paraqitet në seancë, ndërsa ai është munduar që të pengojë rrjedhën e procedurës dhe siç edhe ka theksuar në aktvendimin e veçantë mbi shqiptimin e dënimit, përkundër faktit se të dytë kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës, për pasojat e mosardhjes, i njëjti në situatën konkrete ka vepruar jo profesionalisht duke e penguar zhvillimin e drejtë të procedurës penale dhe duke mos e respektuar gjykatën. Tutje ka deklaruar se pretendimet e mbrojtësit mund eventualisht të ndikojnë në procedurën sipas ankesës ndaj vendimit meritor, apo për veprime procedurale të gjykatës po ashtu ka të drejtë ankesë. Përfundimisht ka theksuar se një kërkesë e tillë, në këtë situatë, reflekton vetëm pakënaqësinë e mbrojtësit me vendimin e gjykatës me të cilin i është shqiptuar një dënim i merituar konform dispozitave ligjore, dhe shpreh vetëm keqpërdorimin e të drejtave të tij procedurale.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtares I.C-S, së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se gjyqtarja ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenin 5 par.2, pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankuesi ka pretenduar se çështja po paragjykohet për faktin se gjyqtarja është shprehur në seancën e datës 30.12.2024 dhe në aktvendimin e datës 09.01.2025, dhe ka cituar shprehjet e gjyqtares “ku pa dyshim mungesa e të pandehurës është marrëveshje paraprake me mbrojtësin e saj e me qëllim të shmangies së shqiptimit të dënimit të mbrojtësit të saj dhe lëshimi i urdhërrestit”, vlen të theksohet se nga ky citim i shkëputur nga nënteksti i tërësishëm i arsyetimit të aktvendimit të datës 09.01.2025 nuk mund të vihet në dyshim se gjyqtarja ka vepruar duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në këtë çështje penale dhe rrjedhimisht në këtë drejtim ky pretendim i ankuesit është i pabazuar. Për me tepër ankesa disiplinore ndaj gjyqtares me tepër paraqet pakënaqësitë e shprehura nga avokati i të pandehurës lidhur me aktvendimin P.nr.331/23 të datës 09.01.2025, ndaj veprimeve të marra nga gjyqtarja me qëllim të drejtimit të procedurës, veprime këto të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, pasi veprimet e tilla procedurale të gjyqtares janë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta, si gjykata kompetente për vlerësimin e saktësisë dhe ligshmërisë së vendimeve të gjyqtarëve. Në këtë rast mbrojtësi i të pandehurës ka qenë i udhëzuar për të drejtën e ankesës dhe ka mund të shpreh pakënaqësitë e tij lidhur me aktvendimin e datës 09.01.2025.

Ndërsa për pretendimet tjera lidhur me mos respektimin e afateve për caktimin e seancës fillestare dhe për caktimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor, të njëjtat pretendime të ngritura kanë të bëjnë me çështje procedurale, e të cilat i njëjti ka mundësi t'i atakoj përmes ankesës mbi vendimin meritore të gjykatës, dhe nga analizimi i tërësishëm i lëndës në fjalë në asnjë rrethanë nuk ka qenë ndonjë tendencë për prolongim nga ana e gjyqtares mirëpo e tërë kjo ka qenë për shkak të ngarkesës dhe vëllimit të madh të punëve me të cilët janë të ngarkuar gjyqtarët.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtares nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye Kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.03/25, me datë 20.02.2025**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarës I.C-S*
- 3. Parashtruesit të ankesës – B.A avokat nga Peja*